

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Durrës

PROGRAMI
I KURSIT TË VEÇANTË
“AXHUSTERI MEKANIKE”

Kodi: AM-20

Miratoi:

DREJTOR

.....

Durrës, 2020

PROGRAMI I KURSIT TE VECANTE

“Akhusteri mekanike”

(AM – 20)

I. Profili Profesional i Axhustatorit

a) Karakteristikat e axhustatorit

Axhustatori është i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar apo i vetpunësuar në reparte axhusterie.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, axhustatori duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë të axhusterise, si dhe **shprehi** profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të axhustatorit.

Suksesi i axhustatorit është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durimi, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e axhustatorit:

Profesioni i axhustatorit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për kontrollin, diagnostikimin, riparimin, axhustimin e detaleve në pajisjet e dëmtuara si dhe shërbime të ndryshme të elementëve mekanike. Ai mund të punësohet ose të vetëpunësohet në reparte shërbimesh dhe riparimesh të këtyre detaleve, si dhe në kompani shitjeje. Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e axhustatorit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një axhustator mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit mekanik.

Për të zhvilluar aktivitet privat në fushën e Axhusterise Mekanike duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Axhustator”.

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: riparues dhe prodhues i detaleve të ndryshëm.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Axhusteri Mekanike”

Në përfundim të kursit Axhusteri Mekanike, kursantët do të jenë të aftë të:

- zbatojnë standardet e profesionit;
- përdorin dokumentacionin teknik për riparime dhe prodhime detalesh;
- organizojnë punën dhe vendin e punës në një repart axhusterie;
- përzgjedhin veglat, mjetet, pajisjet, makineritë dhe materialet e duhura sipas specifikës

se procesit të punës;

- përdorin saktë veglat e pajisjet e punës gjatë riparimit dhe prodhimit të detaleve;
- mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe makineritë në mjedisin e punës;
- përgatisin skicën ose vizatimin e detaleve metalike;
- kryejnë matje të sakta me metër, kalibër, mikrometër dhe këndmatës ;
- kryejnë shënime të sakta;
- kryejnë prerje të detaleve me daltë, me sharrë metalike dore, me gërshërë dhe me gur fleksibel;
- kryejnë punime të vrimave (punime shpimi, kalizvarimi dhe alezimi);
- kryejnë filetimin e jashtëm dhe të brendshëm të detaleve;
- kryejnë punime të limimit të detaleve;
- realizojnë punime smerilimi me dorë, me gur smerilues dhe me gur fleksibël;
- realizojnë lidhje të zbërthyeshme dhe lidhje të pazbërthyeshme të detaleve;
- kryejnë kthime të shufrave dhe të fletëve me vegla dore;
- zbatojnë rregullat e paraqitjes, qëndrimit;
- zbatojnë kuadrin ligjor të veprimtarisë së axhustatorit;
- zbatojnë kërkesat për licensim për ushtrim profesioni;
- komunikojnë me etikë profesionale me eprorët dhe kolegët;
- zbatojnë rregullat e higjienës, sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në ambjentet e punës.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Axhusteri mekanike”.

Pjesëmarrësit në Kursin “Axhusteri mekanike” duhet të jenë mbi 16 vjeç, të jenë të aftë fizikisht e mendërisht, si dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Axhusteri mekanike”.

400 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Axhusteri Mekanike”

Nr	Titulli i Modulit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
	Hyrje në profesionin e Axhustatorit.	AM-01-20	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime;	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të axhustatorit. 2. Kursanti përshkruan nocionet bazë të mekanikës. 3. Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës së axhustatorit. 4. Kursanti përshkruan rregullat e etikës, higjienës, sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. 5. Kursanti përgatit skicën e detaleve. 6. Kursanti përshkruan llojet e provës së materialeve.
2	Matja, shënimi i detaleve.	AM-02-20	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen matje me metër. 2. Kursanti kryen matje me kalibër. 3. Kursanti kryen matje me mikrometër. 4. Kursanti kryen matje me këndmatës.
3	Prerja e detaleve.	AM-03-20	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen prerje me daltë. 2. Kursanti kryen prerje me sharrë metalike dore. 3. Kursanti kryen prerje me gërshërë. 4. Kursanti kryen prerje me gur fleksibël.
4	Limimi i detaleve.	AM-04-20	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen punime të limimit në sipërfaqe të rrafshta dhe cilindrike. 2. Kursanti kryen punime të limimit në sipërfaqe të profiluara dhe me kënd.

5	Punimi i vrimave.	AM-05-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	1. Kursanti realizon punime shpimi. 2. Kursanti realizon punime kalizvarimi dhe me kënd. 3. Kursanti realizon punime alezimi.
6	Filetimi i detaleve.	AM-06-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen filetimin e jashtëm të detaleve. 2. Kursanti kryen filetimin e brendshëm të detaleve.
7	Punime smerilimi.	AM-07-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen punime smerilimi me dorë. 2. Kursanti kryen punime smerilimi me gur smerilues. 3. Kursanti kryen punime smerilimi me gur fleksibël.
8	Punime çmontimi dhe montimi.	AM-08-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	1. Kursanti realizon lidhje të zbërthyeshme të detaleve. 2. Kursanti realizon lidhje të pazbërthyeshme të detaleve.
9	Punime deformimi në të ftohtë.	AM-09-20	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen kthime të shufrave me vegla dore. 2. Kursanti kryen kthime të fletëve me vegla dore.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit “Akhusteri Mekanike”

1. Moduli “Hyrje në profesionin e axhustatorit”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E AXHUSTATORIT	AM-01-20
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i njeh kursantët me veçoritë, funksionet, detyrat, veprimtaritë profesionale, parimet dhe kërkesat kryesore të punës së axhustatorit, me nocionet dhe ligjet bazë të axhusterise dhe konceptet bazë të mekanikës, me tolerancat në prodhim; i njeh ata me mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës së axhustatorit, me përgatitjen e skicave të detaleve, me përshkrimin e provës së materialeve si dhe me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht dhe të jenë mbi 16 vjeç.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të axhustatorit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë qëllimin dhe rëndësinë e profesionit të axhustatorit; - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së axhustatorit; - të përshkruajë mjedisin, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës së axhustatorit; - të përshkruajë proceset kryesore të punës së axhustatorit; - të tregojë organizimin e vogël të punës në një repart axhusterie; - të hartojë grafikun e shërbimeve ditore dhe javore; - të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të axhustatorit; - të zbatojë rregulla të paraitjes dhe qëndrimit gjatë punës; - të përshkruajë kuadrin ligjor të veprimtarisë së axhustatorit në një repart axhusterie; - të tregojë kërkuesat për licensim për ushtrimin e profesionit të axhustatorit;	

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 2 Kursanti përshkruan nocionet bazë të mekanikës.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë konceptet e ngarkesave mekanike në tërheqje, shtypje, përkulje, përdredhje;
- të shpjegojë kuptimin e qëndrueshmërisë ndaj ngarkesave mekanike;
- të përshkruajë materialet kryesore metalike, vetite dhe përdorimet e tyre;
- të përshkruajë detalet dhe përdorimet e tyre;
- të përshkruajë mekanizmat kryesore mekanike dhe përdorimet e tyre;
- të tregojë shkaqet dhe pasojat e konsumimit të detaleve;
- të tregojë rëndësine dhe përdorimin e lubrifikuesve;
- të tregojë metodat kryesore të riparimit të detaleve dhe përdorimet e tyre.
- të përshkruajë tolerancat në prodhim të detaleve sipas sistemit ndërkombëtar të matjeve (ISO).

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, instrumentet, pajisjet dhe materialet e punës së axhustatorit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë mjedisin e punës së axhustatorit në një repart axhusterie;
- të përshkruajë llojet e veglave të punës së axhustatorit dhe përdorimin e tyre;
- të përshkruajë pajisjet dhe instrumentat e punës së axhustatorit;
- të përshkruajë rregulla të mirëmbajtjes së pajisjeve, veglave, instrumentave të punës së axhustatorit;
- të përshkruajë metalet dhe vetitë e tyre;
- të përshkruajë gizën, marketimin dhe klasifikimin e saj;
- të përshkruajë çelikun, marketimin dhe klasifikimin e tij;

- të përshkruajë çelikut instrumental, klasifikimin e tij;
- të përshkruajë materialet metalo - qeramike;
- të përshkruajë metalet me ngjyra dhe lidhjet e tyre;
- të përshkruajë masat plastike (njohuri të përgjithshme);
- të përshkruajë materialin gomë, vetitë fizike, klasifikimin e saj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 4 Kursanti përshkruan rregullat e etikës, higjienës, sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me eprorët, kolegët;
- të zbatojë rregullat e higjienës personale;
- të zbatojë rregullat e higjienës së mjedisit dhe të mjeteve të punës;
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës në një repart axhusterie;
- të përshkruajë rregullat e mbrojtjes nga zjarri, rryma elektrike dhe nga rreziqe të tjera;
- të përshkruajë rregullat e ruajtjes së materialeve dhe mjeteve të punës së axhustatorit;
- të përshkruajë përdorimin e kutisë së ndihmës së shpejtë dhe mënyrën e dhënies së ndihmës së parë;
- të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit të punës në një repart axhusterie.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 5 Kursanti përgatit skicën e detaleve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të tregojë rëndësinë e përgatitjes së skicave të detaleve për riparimin/prodhimin e tyre në punime axhusterie;
- të përshkruajë disa elementë bazë që duhet të përmbajë skica (vizatimi i punës);
- të interpretojë standardet bazë të vizatimit teknik;
- të tregojë përmasat kuotuese në vizatimin teknik;

- të vendosë përmasat kuotuese në skicën e detalit;
- të tregojë llojet e vijave që përdoren në vizatimin teknik;
- të përdorë llojet e vijave në skicën e detalit;
- të lexojë vizatimet teknike në format dhe stampë;
- të lexojë shkallët e vizatimit, gërmat dhe numrat;
- të përdorë shkallët e vizatimit, gërmat dhe numrat në ndërtimin e skicave;
- të lexojë shenjat dalluese të vizatimit;
- të tregojë rregullat mbi vendosjen e përmasave;
- të zbatojë rregullat mbi vendosjen e përmasave në ndërtimin e skicës;
- të përshkruajë projeksionet ortogonale;
- të shpjegojë prerjet dhe seksionet;
- të realizojë paraqitjen e trupave gjeometrike, projeksionet ortogonale të tyre;
- të realizojë hapjen e trupave gjeometrike;
- të shpjegojë konceptet bazë të tolerancave teknike;
- të interpretojë tolerancat sipas sistemit ISO;
- të interpretojë tolerancat e paraqitura në vizatimet teknike;
- të zbatojë tolerancat në ndërtimin e skicës së detalit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 6 Kursanti përshkruan kryerjen e provës së materialeve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë procesin e kryerjes së provave të materialeve dhe llojet e tyre;
- të përshkruajë provat mekanike të materialeve si: prova të tërheqjes, të përkuljes, të përdredhjes, prova dinamike dhe provat e lodhjes së detalit;
- të përshkruajë provat teknologjike të materialeve si: prova e përpunueshmërisë, prova e thyeshmërisë, prova e tubave që i nënshtrohen përpunimit plastik (ndryshim përmasash dhe formash).

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës në një repart axhusterie. Rekomandohet që të bëhen vizita në mjedise e reparte ku bëhen punime axhusterie. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të nxiten të marrin pjesë aktive si në diskutimin e çështjeve teorike, ashtu dhe për kryerjen e veprimtarive praktike. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Kursantët duhet të angazhohen në përshkrimin e veçorive të profesionit të axhustatorit, të funksioneve, detyrave, veprimtarive, veglave, pajisjeve, materialeve, instrumenteve si dhe të rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit ku mbështetet puna e axhustatorit. Ata duhet të praktikohen në ndërtimin e skicave të detaleve. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedisë reale të punës në repart axhusterie. Repart pune të shërbimit ose të prodhimit të detaleve të ndryshme të makinave të axhustatorit mekanik. - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve, dhe instrumentave për punime të ndryshme në repartin e axhusterisë. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. - Materiale ilustruese (pankarta, transparente, makete, skema detalesh, etj.). - Rregullore të mbrojtjes nga zjarri. - Model tipik konkretizues për instruktimin e axhustatorit mekanik. - Medie didaktike (CD, filma etj., për konkretizimin e njohurive dhe aftësive të axhustatorit mekanik).

2. Moduli “Matja, shenimi i detaleve.”

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MATJA, SHËNIMI I DETALEVE.	AM-02-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët në matjen e detaleve me instrumente matës si dhe me shënimin e tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë dhe 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e axhustatorit”.	
Rezultatët e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti kryen matje me metër. Kritëret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të tregojë kuptimin për matjet, kontrollat, shënimet mekanike dhe rëndësinë e tyre; - të përshkruajë procesin e matjes me metër; - të përzgjedhë detalin ku do të bëhen matjet dhe shënimi; - të tregojë mënyrat e matjeve me metër (absolutë/relative); - të përzgjedhë instrumentin matës (metrin), instrumentin kontrollues dhe shënues; - të kryejë matje të sakta me metër në detalin që do të punohet; - të kryejë kontrollin e përmasave dhe formës së detalit gjatë dhe pas matjes, me instrumentet përkatës; - të kryejë shënimet e nevojshme me instrumentin shënues të zgjedhur paraprakisht; - të shpjegojë gabimet gjatë matjes me metër; - të kujdeset për instrumentet matës, shënues dhe kontrollues të përdorur. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. RM 2 Kursanti kryen matje me kalibër. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :	

- të shpjegojë kuptimin për matjen me kalibër;
- të përshkruajë kalibrin si mjet matës, pjesët kryesore të tij;
- të përshkruajë mënyrat e matjeve me kalibër (absolutë, relative);
- të përshkruajë procesin e matjes me kalibër;
- të përzgjedhë detalin ku do të kryen matjet me kalibër;
- të përzgjedhë instrumentin kontrollues dhe shënues;
- të kryejë matje të brendshme e të jashtme me kalibër;
- të kryejë matje të lartësisë, me kalibër në detalin që do të punohet;
- të kryejë matje të thellësisë së vrimave me kalibër;
- të kryejë kontrollin e përmasave dhe formës së detalit gjatë dhe pas matjes me kalibër, me instrumentet përkatës;
- të kryejë shënimet e nevojshme me instrumentin shënues;
- të shpjegojë gabimet gjatë matjes me kalibër;
- të kujdeset për kalibrin, instrumentin kontrollues dhe shënues.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kryen matje me mikrometër.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë kuptimin për matjen me mikrometër;
- të përshkruajë mikrometrin si mjet matës, pjesët kryesore të tij;
- të tregojë llojet e mikrometrave;
- të përshkruajë procesin e matjes me mikrometër;
- të përzgjedhë detalin ku do të kryen matjet me mikrometër;
- të përzgjedhë instrumentin kontrollues dhe shënues;
- të kryejë matje të sakta të përmasave të jashtme me mikrometër;
- të kryejë matje të sakta të përmasave të brendshme me mikrometër;
- të kryejë kontrollin e përmasave dhe formës së detalit që do të punohet gjatë dhe pas matjes;
- të kryejë shënimet e nevojshme me instrumentin shënues;
- të shpjegojë gabimet gjatë matjes me mikrometër;

- të kujdeset për instrumentet e përdorur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti kryen matje me këndmatës.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë kuptimin për matjen me këndmatës;
- të tregojë instrumentet këndmatës;
- të përshkruajë procesin e matjes me këndmatës;
- të për zgjedhë detalin ku do të kryen matjet me këndmatës;
- të për zgjedhë instrumentin kontrollues dhe shënues;
- të kryejë matje të sakta me këndmatës;
- të kryejë kontrollin e përmasave gjatë dhe pas matjes me këndmatës;
- të kryejë shënimet e nevojshme me instrumentin shënues;
- të shpjegojë gabimet gjatë matjes me këndmatës;
- të kujdeset për instrumentet e përdorur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës në një repart axhusterie. Rekomandohet që të bëhen vizita në mjedise e reparte ku bëhen punime axhusterie.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për matjen dhe shënimin e detaleve.
- Kursantët duhet të nxitën të marrin pjesë aktive si për diskutimin e çështjeve teorike, ashtu dhe për kryerjen e veprimtarive praktike.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprime konkrete për të realizuar drejt matjen me metër, kalibër, mikrometër si dhe për të kryer saktë shënimin e detaleve.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.

	- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Reparte pune të shërbimit ose të prodhimit të detaleve. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. - Komplet i veglave dhe instrumentave (metër, kalibër, mikrometër), të nevojshëm për realizimin e matjeve. - Instrumente shënues. - Rregullore të mbrojtjes nga zjarri. - Model tipik konkretizues për instruktimin e axhustatorit mekanik. - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen (rregullore, manuale, standarde, pankarta etj).

3. Moduli “Prerja e detaleve ”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PRERJA E DETALEVE	AM-03-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me procedurat e prerjes dhe i aftëson ata për të kryer prerje me daltë, me sharrë metalike dore, me gërshërë dhe prerje me gur fleksibël.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë dhe 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e axhustatorit” dhe “Matja, shënimi i detaleve”.	
Rezultatët e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti kryen prerje me daltë. Kritëret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën e axhustatorit, shoqëruar me mjetet mbrojtëse; - të përgatisë vendin e punës për prerjen e copës;	

- të përshkruajë procesin e prerjes me daltë;
- të analizojë drejt skicën ose vizatimin e detalit metalik;
- të përzgjedhë drejt gjysmëfabrikatin që do pritët;
- të përzgjedhë drejt veglat e punës;
- të përzgjedhë instrumentet e nevojshëm matës, shënues dhe kontrollues;
- të zbatojë procedurat e vendosjes dhe shtrëngimit të copës në pajisjen mbajtëse (morse);
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me daltë;
- të realizojë matje dhe shënime të sakta gjatë prerjes;
- të realizojë shfrytëzimin racional të gjysmëfabrikatit gjatë prerjes me daltë;
- të kontrollojë cilësinë e prerjes;
- të zbatojë procedurat e heqjes së copës;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë prerjes me daltë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti kryen prerje me sharrë metalike dore.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën e axhustatorit, shoqëruar me mjetet mbrojtëse;
- të përgatisë vendin e punës për prerjen e copës;
- të përshkruajë procesin e prerjes me sharrë metalike dore;
- të analizojë drejt skicën ose vizatimin e detalit metalik;
- të përzgjedhë drejt gjysmëfabrikatin që do pritët;
- të përzgjedhë drejt veglat e punës;
- të përzgjedhë instrumentet e nevojshme matëse dhe shënuese;
- të zbatojë procedurat e vendosjes dhe shtrëngimit të copës në pajisjen mbajtëse (morse);
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me sharrë metalike dore;
- të realizojë matje dhe shënime të sakta gjatë prerjes;
- të realizojë shfrytëzimin racional të gjysmëfabrikatit gjatë prerjes;
- të kontrollojë cilësinë e prerjes;
- të zbatojë procedurat e heqjes së copës;

- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit të punës gjatë prerjes me sharrë metalike dore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kryen prerje me gërshërë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë procesin e prerjes me gërshërë;
- të veshë uniformen e mekanikut axhustator, shoqeruar me mjete mbrojtëse;
- të përgatisë vendin e punës për prerjen e copës me gërshërë;
- të analizojë drejt skicën ose vizatimin e detalit metalik;
- të përzgjedhë drejt gjysmëfabrikatin që do pritë;
- të përzgjedhë drejt veglat e punës;
- të përzgjedhë instrumentet e nevojshëm matës, shënues dhe kontrollues;
- të zbatojë procedurat e vendosjes dhe shtrëngimit të copës në morse;
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me gërshërë;
- të realizojë matje dhe shënime të sakta gjatë prerjes;
- të realizojë shfrytëzimin racional të gjysmëfabrikatit gjatë prerjes;
- të kontrollojë cilësinë e prerjes;
- të zbatojë procedurat e heqjes së copës;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë prerjes me gërshërë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti prerje me gur fleksibël.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën e axhustatorit, shoqëruar me mjetet mbrojtëse;
- të përgatisë vendin e punës për prerjen e copës;
- të përshkruajë procesin e prerjes me gur fleksibël;
- të analizojë drejt skicën ose vizatimin e detalit metalik;

- të përzgjedhë drejt gjysmëfabrikatin që do pritët;
- të përzgjedhë drejt veglat e punës;
- të përzgjedhë instrumentet e nevojshëm matës, shënues dhe kontrollues;
- të zbatojë procedurat e vendosjes dhe shtrengimit të copës në pajisjen mbajtëse (morse);
- të zbatojë teknikat e duhura për prerjen me gur fleksibël;
- të realizojë matje dhe shënime të sakta gjatë prerjes;
- të realizojë shfrytëzimin racional të gjysmëfabrikatit gjatë prerjes;
- të kontrollojë cilësinë e prerjes;
- të zbatojë procedurat e heqjes së copës;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë prerjes me gur fleksibël.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës në një repart axhusterie. Rekomandohet që të bëhen vizita në mjedise e reparte ku bëhen riparime dhe prodhime detalesh.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për prerjen e detaleve..
- Kursantët duhet të nxitën të marrin pjesë aktive si për diskutimin e çështjeve teorike, ashtu dhe për kryerjen e veprimtarive praktike.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprime konkrete për prerjen e detaleve me daltë, sharrë dore metalike, me gërshërë dhe me gur fleksibël.
- Instruktori duhet të nxisë kursantët të angazhohen në diskutime për rastët e ndryshme që paraqitën.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Reparte pune të shërbimit ose të prodhimit të detaleve. - Repart axhusterie i pajisur me kompletët e veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshem për prerje. - Materiale të ndryshëm (çelik, gizë, alumin etj.) me përmasa të ndryshme për të realizuar prerjen. - Daltë, gërshërë, sharrë metalike dore, gure fleksibël. - Rregullore të mbrojtjes nga zjarri, model tipik konkretizues për instruktimin e axhustatorit mekanik. - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen (rregullore, manuale, standarde, pankarta etj.)
---	---

4. Moduli “Limimi i detaleve ”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	LIMIMI I DETALEVE.	AM-04-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët në kryerjen e punimeve të limimit të detaleve në sipërfaqe të rrafshta, cilindrike, të profiluara dhe me kënd.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori, 80% Praktikë dhe 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të aftë fizikisht e mendërisht, të jenë mbi 16 vjeç si dhe të kene kryer modulet “Hyrje në profesionin e axhustatorit”, “Matja, shënimi i detaleve” dhe “Prerja e detaleve”.	
Rezultatët e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti kryen punime të limimit në sipërfaqe të rrafshta dhe cilindrike. Kritëret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën e axhustatorit; - të përgatisë vendin e punës për limim; - të përzgjedhë drejt gjysmëfabrikatin për limim; - të interpretojë drejt skicën ose vizatimin e detalit; - të përzgjedhë drejt veglat, mjetet e punës për limimet e sipërfaqeve të rrafshta dhe cilindrike; - të përzgjedhë limat e duhura për limimet e mësipërme; - të përzgjedhë drejt instrumentet matës dhe kontrollues;	

- të përshkruajë procesin e limimit dhe hapat e punës për limimin e sipërfaqeve të rrafshta dhe cilindrike;
- të zbatojë procedurat e vendosjes dhe shtrëngimit të copës në morse;
- të përcaktojë drejt regjimin e limimit;
- të zbatojë teknikat e duhura për limimin e sipërfaqeve të rrafshta;
- të zbatojë teknikat e duhura për limimin e sipërfaqeve cilindrike;
- të kryejë matje dhe kontrole të sakta gjatë dhe pas limimit të sipërfaqeve të rrafshta dhe cilindrike;
- të zbatojë procedurat e heqjes së copës;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të mbrojtjes së mjedisit gjatë limimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti kryen punime të limimit në sipërfaqe të profiluara dhe me kënd.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e axhustatorit;
- përgatisë vendin e punës për limim;
- përzgjedhë drejt gjysmëfabrikatin për limim;
- të interpretojë saktë skicën ose vizatimin e detalit që do të limohet;
- të përzgjedhë drejt veglat, mjetet e punës për limimet e sipërfaqeve të profiluara dhe me kënd;
- të përzgjedhë drejt limat për limimin e këtyre sipërfaqeve;
- të përzgjedhë instrumentet e duhura matëse dhe kontrolluese;
- të përshkruajë hapat e punës për limimin e sipërfaqeve të profiluara dhe me kënd;
- të zbatojë procedurat e vendosjes dhe shtrëngimit si duhet të copës në morse;
- të përcaktojë drejt regjimin e limimit;
- të zbatojë teknikat e duhura për limimin e sipërfaqeve të profiluara;
- të zbatojë procedurat e duhura për limimin e sipërfaqeve me kënd;
- të realizojë matje dhe kontrole të sakta gjatë dhe pas limimit;

- të zbatojë procedurat e heqjes së copës;
- të kujdeset për veglat, mjetet, instrumentet e përdorur për këto lloje limimesh;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit të punës gjatë procesit të limimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës në një repart axhusterie. Rekomandohet që të bëhen vizita në mjedise e reparte ku bëhen punime axhusterie.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për limimin e detaleve.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprime konkrete për limimin e detaleve me sipërfaqe të rrafshta, cilindrike, të profiluara dhe me kend, në perputhje me standardet dhe rregullat e mbrojtjes në punë.
- Instruktori duhet të nxisë kursantët që të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten.
